



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 108/2013
Prishtinë, më 4.6.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S -II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha- Shala, Fikrim Damka, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Mungoi: Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK; Haxhi Gashi-USAID/GFSI; Besnik Ramadani – KDI; Burim Ejupi – INDEP; Qëndresa Mrasori, praktikante; Sabit Shkodra –“Kosova Press”, gazetar; Naim Krasniqi – “Radio Dukagjini”, gazetar dhe Pranvera Musa- “Kosova Sot”, gazetare.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.5.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-198, për tregtinë e mallrave strategjike;
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së, në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit Nr. 04-P-164, të datës 27.5.2013;
5. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, Propozoj që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, në mënyrë që të merren konsultime shtesë për shkak të rëndësisë së Privatizimit të PTK-së, ku përmes një dëgjimi publik mundemi mandej të nxjerrim si komision, një përfundim apo rekomandim me të mirë, për gjithë këtë proces.

Visar Ymeri, tha se duhet të bëhet një dëgjim publik dhe ne si deputet të marrim informata shtesë, ku do të ftoheshin të gjitha palët, si institucionet, por edhe sindikata e punëtorëve dhe ekspertë apo aktorë, që janë marr më privatizimin e PTK-së. Ne vazhdim tha së nuk ka përfunduar kjo çështje sepse ende nuk është nënshkruar kontrata dhe kemi kohë të diskutojmë edhe si Komision Parlamentar edhe si Kuvend dhe mandej të merret vendimi nga Kuvendi. Po ashtu, kërkoj që ti drejtohet një shkresë, qoftë Qeverisë apo Komisionit Qeveritar për Privatizim, që të sjellët material shtesë për deputetët.

Teuta Sahatqija, tha se ky dokument tashmë është sjellë më vonesë, sepse është dashur më herët të diskutojë Kuvendi për këtë çështje, e jo tani me një dokument prej dy faqe e gjysmë dhe krejt kjo përngjan më shumë si një farse sesa një raport për shqyrtim, duke propozuar që të kërkohet material shtesë.

Myzejene Selmani, tha së është dashtë të diskutohet para se të merret vendimi edhe pse ligji për ndërmarrje publike ia jep të drejtën Komisionit Qeveritar për Privatizim, që të merr vendim, por është dashtë të konsultohet Kuvendi një herë paraprakisht. Në fund edhe ajo kërkoi që të kërkohet material shtesë nga Qeveria.

Rendi i ditës u miratua me heqjen e pikës së katërt (4) nga rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.5.2013

Teuta Sahatqija, tha se duhet të ndryshohet Rekomandimi nga procesverbali i mbledhjes së fundit i datës 28.5.2013, sepse nuk kemi vendos që t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim ky projektligj, por vetëm kemi debatuar dhe nuk kemi sjell asnjë rekomandim.

Kryetari, tha se ne si Komision, e kemi shqyrtuar dhe miratuar këtë Projektligj tashmë në parim dhe nuk kemi nevojë të votojmë edhe një herë për të njëjtën çështje. Unë vetëm kam kërkuar që të procedohet tutje për seance plenare, sipas procedurave për diskutim në parim. Ai i njoftoi deputetët se ka komunikuar edhe me kryetarin e Komisionit për legjislacion dhe do të kërkoj në seance plenare që të hiqet nga rendi i ditës dhe të na kthehet përsëri në diskutim në Komision.

Pas debatit deputetët u pajtuan që Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.5.2013, të miratohet më ndryshimin si në vijim:

Pas debatit Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi në parim Projektligji për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë, për konsulta shtesë.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit Nr. 04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari, tha se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë, duhet ta shqyrtojmë në parim këtë projektligj, duke kërkuar nga deputetët që të paraqesin vërejtjet e tyre në parim, pastaj të formohen grupet punuese për t'i shqyrtuar dhe nxjerr amendamentet.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr.04/L-198, për tregtinë e mallrave strategjike.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij Projektligji, ka këtë përbërje: Myzejene Selmani, raportuese, Teuta Sahatqija, dhe Sala Berisha –Shala, anëtare.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit